

Osmani, videomesazh për  
mërgimtarët: Jeni zemra  
dhe shpirti i Kosovës



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## HOVENIERI: KEMI SHQETËSIME PËR DISA ZGJIDHJE POLITIKE QË I KA BËRË QEVERIA KURTI



Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), së bashku me disa partnerë të tjerë, siç janë Mbretëria e

Bashkuara, Franca, Italia, Gjermani, Bashkimi Evropian, janë të shqetësuar për disa çështje politike që janë bërë nga qeveria Kurti. Kur u pyet nga gazetarët gjatë vizitës së tij në

Gjakovë për raportet që ka ShBA-ja me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, tha se ka shumë çështje që s'është dashur të krijohen pasi që pengojnë synimet e tyre për Kosovën

LDK-ja DHE  
AAK-ja BËHEN  
BASHKË NË  
PRISHTINË,  
PARTIA E  
HARADINAJT DO  
T'I UDHËHEQË  
TRI DREJTORI

F.7



KODI I RI I SJELLJES I PREK  
DEPUTETËT NË XHEP

F.4

"SHUMË MILIONA PËR MIQ DHE  
DOSTA", HARADINAJ KRITIKON  
QEVERINË KURTI PËR TENDERËT  
NJËBURIMORË

F.8

### SPORT



FC PRISHTINA PARAQET  
SAMUELIN DHE RAQIN

F.10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Buniamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjiibiznesi.com](http://www.kolegjiibiznesi.com)  
[info@kolegjiibiznesi.com](mailto:info@kolegjiibiznesi.com)  
030-500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Trumpi zotohet se do t'i bashkojë amerikanët

WASHINGTON, 15 KORRIK - Pas përpjekjes për ta vrarë, ish-presidenti amerikan Donald Trump tha se e ka rishikuar krejtësisht fjalimin që do ta mbajë në Konventën e Partisë Republikane. Në vend se ta kritikojë presidentin aktual Joe Biden, ai tha se do të përçojë mesazhe uniteti. “Do të jetë një fjalim krejt ndryshe. Kjo është një mundësi për ta bashkuar vendin. Mua më është dhënë kjo mundësi”, tha Trumpi për gazetën “Washington Examiner”. Trumpi arriti në shtetin e Uiskonsinit, ku nga sot e deri më 18 korrik zhvillon punimet Konventa e Partisë Republikane. Në këtë ngjarje Trumpit pritet t'i konfirmohet nominimi i partisë si kandidat presidencial në zgjedhjet e 5 nëntorit. Ai do ta mbajë fjalimin të enjten. Pritet, po ashtu, të bëjë të ditur se kush do të jetë kandidati për zëvendës të tij.

Trumpi, 78 vjeç, u qëllua në vesh në një tubim në Pensilvani të shtunën. Sulmuesi i dyshuar i tij, Thomas Crooks, 20 vjeç, u qëllua dhe u vra nga Shërbimi Sekret, por motivi i tij mbetet i paqartë. Nga të shtënat u vra një spektator, ndërsa dy të tjerë u plagosën rëndë. Duke folur për gazetën “Washington Examiner”, Trumpi tha se provat për atë që ndodhi në Pensilvani janë duke u mbledhur. “Energjia që vinte nga njerëzit atje, në atë moment... Është e vështirë ta përshkruash se si ndihej, por e dija se bota po shikonte. E dija që historia do ta gjykojë këtë dhe e dija se duhej t'ua bëja me dije se jam mirë”, tha Trumpi. Në zgjedhjet e nëntorit, Trumpi pritet të garojë kundër presidentit aktual Joe Biden. Biden, në një fjalim nga Zyra Ovale të dielën mbrëma, bëri



thirrje për unitet kombëtar. “Në Amerikë ne i zgjidhim

mosmarrëveshjet në kutitë e votimit e jo me plumba”, tha

Bideni, duke shtuar se “urrejtja nuk duhet të ketë port të sigurt”.

## Gjermania refuzon sërish thirrjet për të dërguar aeroplanë luftarakë në Ukrainë



BERLIN, 15 KORRIK - Qeveria gjermane ka refuzuar sërish thirrjet për dërgim të aeroplanëve ushtarakë në Ukrainë, pasi lideri i opozitës, Friedrich Merz, prej Unionit Demokristian të qendrës së djathtë, ka thënë se e mbështet idenë. Zëdhënësi i Qeverisë, Steffen Hebestreit, ka thënë se Ukraina do të pranojë disa aeroplanë luftarakë F-16 prej partnerëve perëndimorë, të cilët Gjermania nuk i ka. “Nuk ka kuptim që të dërgohen lloje të ndryshme të aeroplanëve luftarakë në Ukrainë”, ka thënë Hebestreit. “Ndonëse aeroplanët luftarakë mund të duken të ngjashëm prej jashtë, ata janë shumë të ndryshëm për t'i menaxhuar.

Duhet trajnime afatgjatë për ta”, ka thënë ai. Merz ka kërkuar të dielën ndihmë shtesë për Ukrainën, në një intervistë të realizuar me transmetuesin gjerman ARD. “Më duket disi e besueshme t'i ndihmojmë Ukrainës ta rifitojë kontrollin e hapësirës së vet ajrore sepse këto sulme me raketa, që janë secilën herë në rritje, kundër infrastrukturës, kundër elektricitetit dhe furnizimeve me ujë, kundër spitaleve, kundër shtëpive të kujdesit, nuk mund të zmbarsen vetëm prej tokës”, ka thënë ai. “Prandaj është konfirmuar dërgimi i aeroplanëve luftarakë në Ukrainë, prej shumë vendeve, përfshirë disa në Evropë.

Ne si evropianë nuk duhet të qëndrojmë mbrapa”. Hebestreit ka thënë të hënën se propozimi i Merzit nuk është i ri, dhe që Merz duhet të ketë njohuri që Gjermania nuk mund të dërgojë aeroplanë të njëjtë në Ukrainë. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën. Përfundimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke e goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Normat e vaksinimit të fëmijëve, në nivelet para-pandemike

GENEVË, 15 KORRIK - Normat globale të vaksinimit të fëmijëve mbetën në nivelet para-pandemike vitin e kaluar, raportuan të hënën Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF). Në vitin 2023, 84 % e fëmijëve në gjithë botën u vaksinuan plotësisht kundër difterisë, tetanozit dhe kollës së keqe - një vaksinim ky i trefishtë që konsiderohet si tregues kryesor i shkallës së vaksinimit të fëmijëve.

Shifra paraqet rënie të lehtë në krahasim me nivelet para-pandemisë së koronavirusit, të regjistruara në vitin 2019, thuhet në raport. Numri i fëmijëve pa një dozë të vaksinimit të trefishtë u rrit në 14.5 milionë vitin e kaluar, nga 12.8 milionë para fillimit të pandemisë, nxjerr në pah raportin. Gjatë pandemisë shumë vende pësuan vonesa apo ndërprerje në programet e tyre të vaksinimit. Në disa vende numri i atyre që nuk u besojnë vaksinave u rrit pas pandemisë,

tha ekspertja e OBSh-së, Katherine O'Brien. Ky zhvillim “po rezulton në vdekje të fëmijëve”, theksoi ajo. Sipas OBSh-së dhe UNICEF-it, konfliktet e armatosura janë një tjetër pengesë për vaksinimin. Raporti vlerëson se më shumë se gjysma e të gjithë fëmijëve të paimunizuar jetojnë në vende të karakterizuara nga paqëndrueshmëritë dhe dhuna. Të dyja organizatat thanë, gjithashtu, se më shumë se 100 vende të botës janë prekur nga shpërthimet e frutit në pesë vitet e fundit.





## LDK-ja dhe AAK-ja bëhen bashkë në Prishtinë, partia e Haradinajt do t'i udhëheqë tri drejtori

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 KORRIK - Lidhja Demokratike e Kosovës ka arritur marrëveshje për koalicion me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës në Prishtinë. Kështu është bërë me dije nga komuna e Prishtinës përmes një njoftimi për medie, ku thuhet se ka bërë një ristrukturim me qëllim të rritjes së efikasitetit të realizimit të projekteve.

Sipas njoftimit të lëshuar nga kjo komunë, për shkak të rëndësisë së planifikimit dhe organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030 dhe Fshatit Olimpik, si dhe rritjes së vëllimit të punës në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor me procesin e digjitalizimit përmes E-Leja, Arbër Sadiki do të përqendrohet në pjesën e planifikimit, ndërsa Florent Maliqi do ta mbulojë fushën e urbanizmit në veçanti të aspekteve ligjore

dhe zbatimit të E-Leja. “Gjithashtu, ekipit sot i janë bashkuar Valbona Vitija-Ajeti dhe Kushtrim Mushica për ta udhëhequr punën në drejtoritë e administratës, përkatësisht të sportit”, thuhet në njoftim. Derisa Bardh Krasniqi së bashku me Vigan Kastratin, sipas komunës do ta vazhdojnë punën me një rol të rëndësishëm në strukturat planifikuese dhe organizative të Lojërave Mesdhetare 2030.



## Hovenieri: Kemi shqetësime për disa zgjidhje politike që i ka bërë qeveria Kurti

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), së bashku me disa partnerë të tjerë, siç janë Mbretëria e Bashkuara, Franca, Italia, Gjermani, Bashkimi Evropian, janë të shqetësuar për disa çështje politike që janë bërë nga qeveria Kurti. Kur u pyet nga gazetarët gjatë vizitës së tij në Gjakovë për raportet që ka ShBA-ja me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, tha se ka shumë çështje që s’është dashur të krijohen pasi që pengojnë synimet e tyre për Kosovën

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 KORRIK - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, gjatë një vizite në Gjakovë, rikonfirmoi mbështetjen e ShBA-së për vendin tonë. Megjithatë, ai para medieve tha se ShBA-ja, por edhe partnerët e tjerë, kanë shqetësime lidhur me disa zgjidhje politike që i ka bërë qeveria Kurti. “Sa iu përket marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe ShBA-së, nganjëherë ndiej se të gjithë doni të jeni psikiatër dhe të diagnostikoni ndonjë sëmundje mendore. Ka shumë njerëz të cilët kalojnë shumë kohë duke u brengosur për këtë çështje. Do ta them atë që e them gjithmonë. Përkushtimi i ShBA-së ndaj popullit të Kosovës është i fuqishëm dhe i hekurt gjithmonë. Kemi qenë me popullin e Kosovës, jemi me të dhe do të jemi. Kjo nuk nënkupton që duhet të pajtohemi me çdo zgjidhje të bërë nga çdo Qeveri e Kosovës. Nuk është e fshehtë se qeveria ime, bashkë me disa prej partnerëve që punojmë, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia e BE-ja, kemi disa shqetësime për disa zgjidhje politike që i ka bërë qeveria Kurti”, u shpreh ai para medieve. Në konferencën për medie Hovenieri deklaroi se pas miratimit të Ligjit për KPK-në dhe KPM-në, ka biseduar me zyrtarët e qeverisë. Ai potencoi se qeveria duhet të sigurohet që



legjislacionet të jenë në përputhje me normat evropiane. “Kam pasur rastin të bisedoj me zyrtarët e qeverisë lidhur me këtë çështje. Dua të them se e kuptoj që ka shqetësime se a janë ligjet në përputhje me standardet

evropiane apo jo. Këshilla e Qeverisë Amerikane për Qeverinë e Kosovës gjithmonë është e njëjta: që të sigurohet që ligjet që miratohen në Kuvend të jenë në përputhje me normat evropiane, sepse ne shohim që

Kosova duhet të jetë një ditë pjesë e BE-së”, ka deklaruar Hovenier. Partitë opozitare në Kosovë kanë paralajmëruar se projektligjin për KPM-në dhe KPK-në do ta dërgojnë në Gjykatën

Kushtetuese. Më 11 korrik Kuvendi i Kosovës ka miratuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe atë për Këshillin e Pavarur të Medieve.

## Vendosen pajisjet e reja elektronike në Kuvend

Prishtinë, 15 korrik - Salla e Kuvendit të Kosovës është në rinovim e sipër, ndërsa shefi i

kabinetit të Glauk Konjufcës, Ilir Kërçeli, ka njoftuar se tashmë veçse janë vendosur

pajisje të reja elektronike për votim dhe mikrofon. “Pas 21 vitesh po ndërrohen pajisjet e

sallës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, ka shkruar Kërçeli në “Facebook”.







# Kodi i ri i Sjelljes i prek deputetët në xhep

PRISHTINË, 15 KORRIK - Deri në gjysmën e pagës, apo mbi 600 euro në muaj, mund të humbin deputetët e Kuvendit të Kosovës nëse gjatë seancave plenare dhe në mbledhjet e trupave punues të Kuvendit përdorin gjuhë joparlamentare apo dhunë fizike. Ndëshkimet e tilla parashihen në draftin e ri të Kodit të Sjelljes për deputetët e Kuvendit, të miratuar në muajin prill të këtij viti nga Komisioni për legjislacion, mandate, imunitete, rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit. Përgatitja e këtij draft-Kodi është përpjekje për ta parandaluar përdorimin e fyerjeve, sharjeve dhe dhunës fizike nga deputetët, tha Adnan Rustemi, kryetar i këtij komisioni. “Përmes këtij Projekt-kodi po bëjmë përpjekje ta lartësojmë modelin e deputetit, në kuptimin e një deputeti të përgjegjshëm llogaridhënës, që të sillet me përgjegjësi në raport me funksionin dhe qytetarin”, tha Rustemi për “Radion Evropa e Lirë”. Miratimin e një Kodi të tillë e vlerësojnë të domosdoshëm disa nga organizatat joqeveritare që monitorojnë punën e Kuvendit, të tjera dyshojnë se Kodi do të ndikojë në përmirësimin e sjelljes së deputetëve.

## Çfarë parasheh drafti i Kodit?

Në këtë dokument që e ka siguruar “Radio Evropa e Lirë”, thuhet se Kodi do ta adresojë sjelljen e deputetëve në seanca dhe komisione, gjuhën joparlamentare, përdorimin e telefonave, veshjet e zyrtarëve dhe veprimet e tjera të ndaluara gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Sipas Kodit, deputetët duhet të përmbahen nga përdorimi i gjuhës së pahijshme, urrejtëse, fyese ose

kërcënuese.

Për të gjitha veprimet joadekuate, sipas Kodit, parashihen dënime me gjobë, varësisht a janë shkelje të rënda apo të lehta. Shkelje të lehta konsiderohen: pengimi i mbarrëvajtjes, pasthirma, zhurmimi dhe ndërprerja e fjalës, përdorimi i celularit ose i laptopit dhe mosrespektimi i Kodit të veshjes.

Kurse shkelje të rënda janë përdorimi i dhunës fizike, përdorimi i fjalëve, frazave ose sinonimeve që poshtërojnë ose cenojnë dinjitetin e tjetrit, shpërdorimi i pozitës për përfitim të interesave personale, nxitja e urrejtjes, jotoleranca, dhuna apo ngacmimi seksual.

Në rast të shkeljes së Kodit të Sjelljes, ndaj deputetëve zbatohen masat ndëshkuese duke filluar nga vërejtja me shkrim, më pas suspendimi nga pjesëmarrja në tri seanca plenare dhe tri mbledhje të komisioneve, e deri te sanksionet financiare që arrijnë në 50 për qind të pagës bazë. Paga bazë e një deputeti në Kosovë është 1.804 euro.

Për pjesëmarrje në mbledhje të komisioneve dhe grupeve punuese ata përfitojnë shtesa: 20 për qind të pagës bazë apo mbi 360 euro. Rustemi tha se draft-Kodi është proceduar për një nga seancat plenare të Kuvendit.

Zyrtarë nga Kuvendi i Kosovës thanë për “Radion Evropa e Lirë” se kryesia e Kuvendit do të përcaktojë se kur do të vendoset në rend dite për shqyrtim Projekt-kodi. Por, data për shqyrtimin e këtij dokumenti ende nuk është caktuar.

## Kush i “ndëshkon” deputetët?

Organi kompetent për zbatimin dhe shqiptimin e masave të këtij Kodi është Këshilli për Etikë. Këshilli përbëhet nga nëntë anëtarë, prej të

## Pagat minimale në Evropë

Në kontinentin evropian, Kosova e ka pagën më të vogël minimale, ndërsa Luksemburgu i prin listës si shteti me pagën më të madhe minimale. Paga minimale e një shteti përcaktohet me ligj dhe zbatohet për shumicën e punonjësve të atij shteti.

cilëve katër anëtarë do t'i përkasin shumicës parlamentare, tre opozitës dhe dy anëtarë të tjerë do t'u përkasin komuniteteve joshumicë. Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit, mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, në Kuvendin e Kosovës, Adnan Rustemi tha se Këshilli i Etikës synon të përbëhet nga deputetë me integritet të lartë moral dhe profesional. “Dhe, në mënyrë të paanshme të trajtojë secilin rast që denoncohet nga ana e deputetëve”, thekson Rustemi. Sipas Kodit, Këshilli duhet të ketë një kryetar dhe një zëvendëskryetar, si dhe në përbërjen e tij duhet të reflektojë barazia gjinore. Kryetari i Këshillit propozohet nga grupi më i madh parlamentar i shumicës, kurse zëvendëskryetari propozohet nga grupi më i madh parlamentar i opozitës. Anëtarët e Këshillit, së bashku me kryetarin dhe zëvendëskryetarin zgjedhën në votim të hapur nga Kuvendi, me propozimin e Kryesisë së Kuvendit. Vendimet për ndëshkime merren me “miratimin e shumicës së anëtarëve”.

## “Kodi i domosdoshëm”

Duke vlerësuar volumin e sjelljeve joparlamentare të ligjëvënësve, draftimi i Kodit të kësaj natyre, që zgjeron praktikën ndëshkuese, është i domosdoshëm, thotë Arbër Thaçi nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Sipas tij, jo rrallëherë në seancat e Kuvendit të Kosovës debatet nga deputetët dalin jashtë

kontrollit, duke përfshirë përdorimin e gjuhës së ashpër, ofendimet, fyerjet, por edhe përlëshjet fizike. Kjo zakonisht ndodh ndërmjet deputetëve në pushtet dhe atyre në opozitë, varësisht se cila parti udhëheq qeverinë. Përveç gjuhës së ashpër, fyerjeve, sharjeve dhe ofendimeve, më 13 korrik të vitit të kaluar pati edhe përlëshje fizike ndërmjet deputetëve të Partisë Demokratike dhe pjesëtarëve të qeverisë nga Lëvizja Vetëvendosje, konkretisht mes Mërgim Lushtakut dhe zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bislimi.

Në raportin e monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2023, Instituti i Kosovës për Drejtësi ka vërejtur se është përdorur gjuhë seksiste, mizogjene, raciste dhe homofobe. Kjo gjuhë është kritikuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023. Në këtë raport thuhet se, “përveç tensionimit në Kuvend, disa deputetë përdorën gjuhë nxitëse kundër kundërshtarëve politikë, duke përfshirë stereotipizimin dhe gjuhë jo të përshtatshme në aspektin gjinor”. Liridon Salih, koordinator i projekteve në Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), shprehet se ndëshkimi me gjoba mund ta përmirësojë sjelljen e deputetëve nëpër seanca. Ai sqaron se edhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës ndalohet përdorimi i gjuhës joparlamentare dhe përdorimi i

dhunës, por masat ndëshkuese janë të lehta. “‘Prekja në xhep’ e deputetëve do të ketë efekt dhe do të ketë më pak përdorim të gjuhës jo të përshtatshme, qoftë në seanca qoftë në komisione”, vlerëson Salih. Arbër Thaçi nga KDI-ja dyshon se ky dokument garanton përmirësim të situatës.

“Pa një zbatim më të prerë të rregullave ndëshkuese, Kodi mund të shndërrohet në një dokument që nuk gjen zbatim në praktikë”, konsideron ai.

Por, në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD) konsiderojnë se dënimet financiare mund të mos jenë pengesë efektive për deputetët e pasur ose ata me të ardhura të konsiderueshme jashtë Kuvendit. Në një analizë të publikuar në fillim të muajit qershor, të quajtur Kodi i Sjelljes së Deputetëve, thuhet se “përqendrimi në dënimet financiare zhvendos fokusin nga parimet e sjelljes së mirë dhe shërbimit publik në një sistem ndëshkimi thjesht monetar”.

Në këtë analizë, ndërkaq, thuhet se draft-Kodi përmban dispozita që janë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit.

Sipas Rregullores aktuale, llojet e masave në rast të pengimit të zhvillimit të seancës janë: ndërprerja e fjalës, vërejtje me paralajmërim për largim nga seanca plenare dhe largimi nga seanca që shoqërohet me sanksione financiare me kompensimin e një seance plenare. “Por, jo deri në 50 për qind të pagës bazë”, thuhet në analizën e IKD-së. Ndryshe, një kod të tillë, Kuvendi i Shqipërisë e ka miratuar para gjashtë vjetësh, më 2018. Njëjtë si në Kosovë, edhe në Shqipëri Kodi i Sjelljes zbatohet për të gjitha aspektet e jetës publike të deputetit. Në vitin 2019 Kodi i Sjelljes është miratuar edhe nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut.



# KPK-ja: Qeveria injoroi propozimet tona për ligjin e ri

PRISHTINË, 15 KORRIK - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka njoftuar opinionin publik se Qeveria e Kosovës në vazhdimësi ka injoruar dhe refuzuar komentet, sugjerimet dhe propozimet e përfaqësuesve të deleguar të KPK-së në grupet punuese, të formuara nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe në komisionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të ri për KPK-në, i cili është miratuar më 11 korrik 2024. “Kjo praktikë e njëanshme e miratimit të akteve ligjore, tregon qartazi se Qeveria e Kosovës dhe shumica në Kuvendin e Kosovës, me vetëdije dhe në emër të reformave, synojnë të bëjnë të kundërtën e reformës, pra bllokimin dhe defunksionalizimin e sistemit prokurorial. KPK-ja thekson se miratimi i këtij ligji përbën mosrespektim dhe shkelje të hapur të parimeve kryesore të Deklaratës së Përbashkët të Zotimit, që, në vetvete, paraqet një lloj absurditeti të llojit të rrallë, ngaqë përbërja e Ekzekutivit aktual, gjegjësisht, Ministria e Drejtësisë, nuk po arrin assesit të shmangë qëndrimet politike në raport me sistemin prokurorial, duke mos përfillur sugjerimet e shumanshme dhe duke rënë në kundërshtim jo vetëm me kërkesat e bazuara të përfaqësuesve të KPK-së, por



edhe me kërkesat dhe rekomandimet e përfaqësuesve të Bashkimit Evropian dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare”, është thënë në reagimin e KPK-së. Megjithatë, KPK-ja është shprehur mirënjohëse dhe falënderuese në mënyrë të veçantë ndaj përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile në vend, të cilët janë vënë në mbrojtje të këtyre parimeve. “KPK-ja është mirënjohëse dhe falënderuese në mënyrë të

veçantë ndaj përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile në vend, të cilët u vunë në mbrojtje të këtyre parimeve dhe insistuan me ngulm që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës të mos injorojnë rekomandimet e institucioneve vendore, Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe OSBE-së sa i përket Projektligjit për Këshillin Prokurorial. Me këtë rast, KPK-ja është bashkuar plotësisht me thirrjet dhe apelet kuptimplota për respektimin e normave dhe

standardeve evropiane para miratimit të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në Kuvend, duke kritikuar ashpër qasjen e pushtetit lidhur me cenimin e pavarësisë së institucioneve kushtetuese të vendit, siç është KPK-ja”, është thënë në këtë reagim. Më tutje, KPK-ja e ka akuzuar pushtetin për ndërhyrje në sistemin prokurorial të Kosovës. “Realisht, kjo tendencë e pushtetit, e zbuluar tashmë plotësisht, paraqet ndërhyrje

rigoroze në sistemin prokurorial dhe në tërë sistemin e drejtësisë, duke përtërirë çdo ditë veprime dhe lloj-lloj farsash dhe insinuatash, me qëllimin e vetëm që në emër të kinse synimit të fuqizimit të llogaridhënies më të madhe në sistemin prokurorial, të arrihet ekuilibri i përbërjes me anëtarë prokurorë dhe joprokurorë, por që, në vetvete është tentim për kapjen dhe dirigjimin e KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit dhe cenon mandatin kushtetues dhe pavarësinë e sistemit prokurorial, duke pamundësuar funksionalizimin e tij dhe duke e bërë atë lehtësisht të ndikuar nga politika. Përfundimisht, Këshilli Prokurorial i Kosovës, potencon se mbetet i përkushtuar për të mbështetur proceset reformuese dhe angazhohet që së bashku me të gjithë partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, të bashkëveprojë në çdo lloj nisme që ka për qëllim reformimin e nevojshëm, në mënyrë që të fuqizohet sundimi i ligjit në Kosovë dhe sistemi prokurorial të bëjë punën e vet të pavarur, profesionale, llogaridhënëse dhe transparente, por njëkohësisht kërkon edhe respektimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe mënjanimin e çfarëdo tendence për kapjen antikushtetuese të institucioneve të pavarura të vendit”, është thënë në reagimin e KPK-së.

## Kërkohet nga bizneset që kur vendosin kamera t'i respektojnë kriteret e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

PRISHTINË, 15 KORRIK - Agjencia për Informim dhe Privatësi përmes një reagimi publik ka kërkuar nga bizneset që kur të vendosin kamera t'i respektojnë kriteret e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në njoftim thuhet se bizneset që përdorin kamera për vëzhgim fillimisht duhet ta bëjnë vlerësimin se është e nevojshme vendosja e kamerave dhe i njëjti veprim nuk mund të arrihet me mjete të tjera si, p. sh., duke vendosur një ndriçim më të madh. “Të marrin vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë ku do të përshkruajnë qëllimin e vendosjes, numrin e kamerave, të caktoshin personin përgjegjës dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së regjistrimeve (vini re, LMDhP ka paraparë që kohëzgjatja e ruajtjes së këtyre regjistrimeve të jetë më së shumti një muaj, përveç nëse kërkohen ndryshe për qëllime legjitime)”, thuhet në njoftim. Më tutje, thuhet se bizneset duhet t'i informojnë personat e

mbikëqyrur: të vendosin njoftime të dukshme që informojnë individët se zona është nën vëzhgim. “Ta përcaktojnë qëllimin dhe legjitimitetin: të sigurojnë që përdorimi i kamerave të jetë për qëllime të ligjshme dhe të përcaktuara qartë, si përmirësimi i sigurisë dhe parandalimi i krimeve. Të njoftojnë në mënyrë të duhur me shkrim të punësuarit lidhur me sistemin e vëzhgimit me kamerë dhe me të drejtat e tyre”, theksohet në njoftim. Më tej, bëhet me dije se bizneset duhet t'i mbrojnë të dhënat personale: të sigurojnë që të dhënat e mbledhura nga kamerat janë të mbrojtura nga qasja e paautorizuara dhe të përpunohen në mënyrë të ligjshme. “Agjencia kërkon nga bizneset që të ndërmarrin veprime për vendosjen e këtyre masave që janë esenciale për të siguruar që bizneset të respektojnë të drejtat e privatësisë së individëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të përmirësojnë sigurinë e tyre”.





## Në Rahovec nis zyrtarisht aktiviteti i mirëpritjes së mërgimtarëve

**RAHOVEC, 15 KORRIK** - Komuna e Rahovecit ka nisur zyrtarisht aktivitetin e mirëpritjes së mërgimtarëve për nder të “Muajit të mërgimtarëve”.

Në një pritje të organizuar në oborrin e komunës, ku morën pjesë mërgimtarë që jetojnë në vende të ndryshme të botës, kryetari Smajl Latifi bashkëbisedoi me ta tema

nga më të ndryshmet. “Gjatë bashkëbisedimit i njoftova se komuna e Rahovecit, në vazhdim, do të ketë një mori aktivitete kulture, sportive, koncerte etj., për nder të këtij muaji. Po ashtu, komuna e Rahovecit, për nder të ‘Muajit të mërgimtarëve’ 2024, ka hapur sportelin për mërgimtarë, ku do të

njoftohen për të gjitha shërbimet administrative komunale, kështu duke qenë sa më afër tyre, të cilët muajt korrik e gusht i shfrytëzojnë për të qëndruar në vendlindje. Mirë se erdhët dhe mirë se vini, mërgimtarë! Ju uroj qëndrim të këndshëm në vendlindje!”, ka thënë kryetari Latifi.



## Kurti mirëpriti në takim drejtoreshën e re të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, flasin për mundësitë e bashkëpunimit

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mirëpriti në takim drejtoreshën e re të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Veronika Vashchenko. Kryeministri Kurti e uroi Vashchenkon për detyrën e re dhe i ofroi bashkëpunim të afërt nga ai dhe ministritë e agjencitë e linjës në fushën e rinisë dhe edukimit. “Diskutuan për programet dhe bashkëpunimet aktuale në edukimin gjithëpërfshirës, edukimin në fëmijërinë e hershme dhe punën praktike në kuadër të programit ‘Kosovo Generation Unlimited’, por edhe për mundësitë për të bërë edhe më shumë, sidomos në promovimin dhe zhvillimin e

vullnetarizmit të rinj”, thuhet në njoftim.

Gjatë takimit u veçua rëndësia e përpunimit të të dhënave të mbledhura nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, u mirëprit votimi i Ligjit për Rininë që u miratua javën e kaluar në Kuvend dhe u vlerësua përfshirja e rinisë dhe kapitalit njerëzor në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim.

Ky ishte takimi i parë ndërmjet kryeministrit Kurti dhe drejtoreshës së UNICEF-it në Kosovë, Veronika Vashchenko. Vashchenko, shtetase e Ukrainës, u emërua në këtë pozitë në qershor të këtij viti.



## Policia rajonale e Ferizajt bën apel për kujdes nga zjarret

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Policia rajonale e Ferizajt ka marrë masat e nevojshme dhe ka angazhuar personel të mjaftueshëm për menaxhimin e rasteve të zjarreve në rajonin e Ferizajt.

Policia Rajonale e Ferizajt ka njoftuar se po angazhohet me përkushtim për parandalimin e zjarreve, duke koordinuar aktivitetet me institucionet lokale dhe agjencitë e tjera përkatëse. “Aktualisht në rajonin e Ferizajt nuk kemi asnjë vatër, apo lokalitet të përfshirë nga zjarret, por policia apelon tek qytetarët të kenë kujdes në përhapjen e zjarreve, të mos i djegin hapësirat fushore dhe pyjet. Policia do të jetë e pakompromis ndaj të gjithë atyre që me qëllim shkaktojnë zjarrvënie. Do të ndjekë penalisht të gjithë personat/individët që shkaktojnë zjarrvënie të qëllimshme, apo si pasojë e



neglizhencës së tyre ndodhin zjarret. Falënderojmë qytetarët për bashkëpunimin që kanë me policinë dhe ftojme qytetarët që nëse kanë informacione rreth atyre personave që me dashje

shkaktojnë zjarrvënie të lajmërojnë stacionin më të afërt të policisë, apo përmes aplikacionit digjital ‘Lajmëro Policinë’”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

## Flamuri i Sindikatës së Policisë ngrehet në majën Mytikas të Greqisë

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Flamuri i Sindikatës së Policisë së Kosovës është ngretur në majën Mytikas në Greqi, e cila është e lartë 2 mijë e 918 metra. “Aktivisti i njohur sindikal nga rajoni i Pejës, njëherësh zyrtari policor Naser Zeqiraj, e ka

përfaqësuar Sindikatën e Policisë së Kosovës, me bashkalpinistë të ndryshëm, ku gjatë këtij aktiviteti, aplinisti ngrehu flamurin e Sindikatës në majën Mytikas (Olimpit) 2918m në shtetin grek”, ka njoftuar Sindikata e Policisë së Kosovës.



## Ushtarët grekë dhe hungarezë të KFOR-it kryejnë trajnime për t'u bërë ballë turmave

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Forca paqeruajtëse e NATO-s në Kosovë (KFOR) ka kryer ushtrime për kontrollin e turmave dhe heqjen e pengesave. “Trajnimi u

mbështet nga ushtarët e batalionit rezervë taktik hungarez të KFOR-it, të cilët i ndihmuan ata të njihen me teknikat, taktikat dhe procedurat specifike për këto

lloj ushtrimesh”, ka njoftuar KFOR-i.

KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX).





Osmani, videomesazh për mërgimtarët: Ju jeni zemra dhe shpirti i Kosovës

PRISHTINË, 15 KORRIK - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, përmes një video-mesazhi thotë se këto ditë Kosova frymon me mërgatën e dashur. Osmani, duke u uruar mirëseardhje mërgimtarëve, ka pohuar se dyert, zemrat dhe shtëpitë tona janë të hapura për ta, pasi ata i japin shpirt Kosovës. “Mërgatë e dashur, motra dhe vëllezër. Sa herë ktheheni në atdheun tuaj, ju ktheheni te familjet tuaja, te të dashurit tuaj, te kujtimet e tuaja, te toka juaj. Kthimi juaj

është ritakim dhe ribashkim, që kapërcen distancën dhe kohën”, ka theksuar ajo. Më tutje, presidentja ka pohuar se bujaria dhe përkushtimi i mërgimtarëve për ta mbajtur të fortë lidhjen me atdheun është i jashtëzakonshëm. “Malli për Kosovën është një lidhje që na bashkon, kudo që të na çojë jeta. Kthimi juaj këtu forcon identitetin tonë kolektiv dhe na kujton shpirtin e qëndrueshëm të popullit tonë. Kosova tani më shumë se kurrë ka nevojë për ju.

Përvojat, aftësitë dhe perspektivat tuaja janë tejet të çmueshme, ndërsa ne vazhdojmë ta ndërtojmë një të ardhme më të ndritshme për atdheun tonë të dashur. Ju ktheheni në vatrat tuaja. Ju ktheheni në Kosovën tuaj, atdheun tuaj shpirtëror. Dyert, zemrat dhe shtëpitë tona janë të hapura sepse ju jeni zemra dhe shpirti i Kosovës”, ka deklaruar Osmani. Një numër i madh i mërgimtarëve kanë filluar të vijnë në Kosovë për pushime verore.



Qendra ‘Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur’: Gjykata Themelore në Prishtinë mohon gjenocidin në Kosovë

PRISHTINË, 15 KORRIK - Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”, kryetar i së cilës është veprimtari Bardhyl Mahmuti, i ka drejtuar ankesë publike Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Departamenti për Krime të Rënda në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke theksuar se Departamenti për Krime Luftë dhe Gjykata Themelore në Prishtinë kanë shkelur rëndë të drejtën e viktimave dhe të mbijetuarve të gjenocidit në fshatin Izbicë duke dënuar me vetëm 15 vjet burgim Muharrem Alidemajn për pjesëmarrje në krime luftë gjatë vitit 1999 në Izbicë. Sipas Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”, Gjykata Themelore në Prishtinë mohon gjenocidin në Kosovë. “Vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës e bën edhe më të rëndë këtë papërgjegjësi, sepse krijon precedentin që mund të përdoret nga mohuesit e gjenocidit në Kosovë si argument i jurisprudencës së gjykatave vendore, se gjoja në Kosovë nuk ka ndodhur gjenocid, madje as krime kundër njerëzimit, por vetëm krime të shkallës më të ulët: krime luftë! Ftojmë anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të



Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit dhe të Gjykatës së Apelit, që të ushtrojnë ndikimin e tyre në përputhje me kompetencat që kanë që të rikthejnë rastin e Muharrem Alidemajt për rigjykim dhe të kërkojnë rikualifikimin e veprës penale nga krime luftë në krim të gjenocidit, si kusht paraprak për të ngadhënjyer drejtësinë dhe të vihet përpara përgjegjësisë individuale për pjesëmarrjen e tij në krimin e

gjenocidit në fshatin Izbicë!”, është theksuar në ankesën e kësaj qendre. Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” ka rikujtuar se në bazë të së drejtës penale ndërkombëtare, klasifikimi i krimeve më të rënda theksohet: 1. në kategorinë e parë është krimi i gjenocidit, si krim më i rëndë, që ka për qëllim të shkatërrojë tërësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar si

të tillë; 2. në kategorinë e dytë janë klasifikuar krimet kundër njerëzimit, ku futen veprat që janë kryer gjatë një sulmi të përgjithshëm dhe sistematik të drejtuar kundër një popullsie civile; 3. në kategorinë e tretë dhe të fundit janë krimet e luftës, ku përfshihen krimet që ndodhin gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar apo jo ndërkombëtar dhe nuk janë respektuar të drejtat e kategorive

të mbrojtura me Konventat e Gjenevës të vitit 1949; 4. krimi i agresionit si kategori e katër është e një natyre tjetër. “Duke pasur parasysh faktin, që përkundër asaj se prokurori Ilir Morina ka qenë në dijeni të përmbajtjes së vendimeve të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, të cilave u referohet, ai ka përpiluar një aktakuzë që degradon natyrën e krimit që është kryer në fshatin Izbicë, duke e kualifikuar si “krim luftë”; Duke pasur parasysh faktin, se mbi bazën e kësaj aktakuze trupi gjykues i Gjykatës Themelore të Prishtinës, i përbërë nga Vesel Ismajli, Kushtrim Shyti dhe Violeta Namani, sollën vendimin që legjitimon degradimin e natyrës së krimit që është kryer në fshatin Izbicë; Duke vepruar në këtë mënyrë, prokurori dhe trupi gjykues në fjalë kanë dëshmuar papërgjegjësi profesionale me pasoja të mëdha. Qendra ‘Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur’ bën ankesë publike për shkak se Departamenti për Krime Luftë dhe Gjykata Themelore në Prishtinë kanë shkelur rëndë të drejtën e viktimave dhe të mbijetuarve të gjenocidit në fshatin Izbicë!”, është theksuar në ankesën publike të Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”.

KOMF-i shpreh shqetësim për situatën e rëndë të fëmijëve që kërkojnë lëmoshë

PRISHTINË, 15 KORRIK - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF ka shprehur shqetësim për situatën e rëndë të fëmijëve që kërkojnë lëmoshë apo punojnë në rrugë. “Ditëve të fundit është vënë re një rritje e rasteve të fëmijëve të cilët kërkojnë lëmoshë, sidomos në orët e vona të natës. Fëmijët po përballen me një sërë rreziqesh serioze për shëndetin dhe jetën e tyre. Këtu nuk bëjnë përjashtim as fëmijët nën tre vjeç dhe foshnjat e ekspozuara në temperatura të larta mbi 35 gradë celsius gjatë ditës.

Fëmijët në situatë rruge janë të ekspozuar ndaj formave të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, përfshirë: neglizhimin, keqtrajtimin, abuzimin fizik dhe emocional. Fëmijët po kërkojnë lëmoshë edhe gjatë orëve të vona të natës, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të shfrytëzimit seksual dhe/ose trafikimit”, është thënë në njoftimin e KOMF-it. KOMF u bënë thirrje komunave dhe institucioneve komunale të ndërmarrin masa urgjente për t’i mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve në situatë rruge.

“KOMF i bën thirrje prindërve që të mos keqpërdorin dhe shfrytëzojnë fëmijët për kërkim të lëmoshës dhe për punë të rënda. Shfrytëzimi i fëmijëve përbën veprë penale dhe sanksionohet sipas Kodit Penal të Kosovës. KOMF i bën thirrje qytetarëve, sidomos atyre që vinë nga diaspora, të mos ofrojnë lëmoshë për fëmijët. Dhënia e lëmoshës mund të nxisë edhe më shumë daljen e fëmijëve në rrugë dhe kështu rrezikohet shëndeti, mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve”, është theksuar në njoftimin e KOMF-it.





## Bien çmimet e naftës, shkak rritja e dollarit amerikan

PRISHTINË, 15 KORRIK - Çmimet e naftës ranë të hënën për shkak të rritjes së dollarit amerikan. Pasiguria politike në ShBA mbështeti rritjen e dollarit. Tendenca rritëse e dollarit amerikan kundrejt valutave të tjera zbuti kërkesën për naftë dhe mbështeti rënien e çmimeve. Indeksi i dollarit amerikan u rrit 0.11 % në 103.892 në orën 10.57 të mëngjesit me orën lokale

(0756 GMT).

Standardi ndërkombëtar i papërpunuar Brent u tregtua me 84,80 dollarë për fuçi në orën 10:57 të mëngjesit me orën lokale (0757 GMT), një rënie prej 0,27 % nga çmimi i mbylljes prej 85,03 dollarë për fuçi në seancën e mëparshme tregtare.

Standardi amerikan West Texas Intermediate (WTI) tregtohej me 80,75 dollarë për fuçi në të

njëjtën kohë, një rënie prej 0,33 % nga seanca e mëparshme që u mbyll me 81,02 dollarë për fuçi.

Dollari i fortë ul kërkesën duke e bërë naftën më të shtrenjtë për përdoruesit e valutës së huaj. Ndërkohë, përpjekjet për të zbatuar një armëpushim në Lindjen e Mesme, shtëpia e shumicës së rezervave globale të naftës, vazhdojnë të ndikojnë në çmimet e naftës.



## Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane mbështet iniciativën e kryeministrit për garantimin e kredive

PRISHTINË, 15 KORRIK - Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, dega në Kosovë, përmes një komunikate për medie ka vlerësuar lart iniciativën e kryeministrit Albin Kurti për garantimin e kredive për pronarë të bizneseve nga diaspora që dëshirojnë të investojnë në Republikën e Kosovës. Sipas tyre, ky është një veprim i duhur e që pritet të ketë rezultate të dukshme gjatë ditëve në vijim.

Shkelzen Jusaj, kryetar i Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, dega në Kosovë, ka falënderuar kryeministrin Kurti për iniciativën e marrë për garantimin e kredive. Ai, po ashtu, kërkon nga kryeministri për ta rishikuar edhe Ligjin për Investime Strategjike pasi që, sipas tij, ky ligj deri më tani nuk ka arritur të japë rezultate. Jusaj thotë se në ligjin aktual duhen

përmirësime për ta rritur efikasitetin dhe për të tërhequr më shumë investime nga Diaspora. “Ne propozojmë krijimin e një zone industriale të dedikuar vetëm për prodhim, ku do të ofrohet infrastruktura e nevojshme për funksionimin e suksesshëm të bizneseve. Në këtë zonë industriale sugjerojmë që 50 % e kapacitetit të jetë e dedikuar për investitorët e diasporës dhe 50 % për investitorët vendorë” ka thënë Jusaj, kryetar i Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane dega në Kosovë.

Ai më tutje sugjeroi se, për t'i stimuluar bizneset e reja, propozojnë që bizneset fillestare tregtare të lirohen nga tatimi në fitim për 3 vjet, ndërsa bizneset fillestare prodhuese për 5 vjet. Këto masa, sipas tij, do të kontribuonin në krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin dhe



rritjen e sektorit privat. Sipas Jusajt, Unionit i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane është i gatshëm të bashkëpunojë dhe ta ofrojë

kontributin për realizimin e këtyre propozimeve, si dhe është në përgatitje të shumë propozimeve të tjera. “Ne besojmë se me një qasje

të koordinuar dhe mbështetje të qëndrueshme mund të arrihen rezultate pozitive për ekonominë e Kosovës” ka thënë Jusaj.

## “Shumë miliona për miq dhe dosta”, Haradinaj kritikon qeverinë Kurti për tenderët njëburimorë



PRISHTINË, 15 KORRIK - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka shkruar në “Facebook” një shkrim me titull “Gropat e zeza buxhetore dhe ‘arritjet historike’ të Qeverisë”.

Haradinaj ka thënë se Kosova është në sanksione të BE-së dhe ShBA-së dhe kjo është e paparë dhe historike. “Dëmi deri tash, rreth 300 milionë euro, pra gropë e madhe e buxhetit dhe bajagi historike. Albini e ka implementuar marrëveshjen e 2013-s për

stickers, targa të veturave dhe sot paska thënë edhe marrëveshjen për energji dhe kjo është historike. E ka marrë statusin e ‘Veteranit Luftëtar’ pa e veshur kurrë uniformën e UÇK-së dhe pa prekur kurrë armë me dorë, siç e parasheh ligji. Kjo s’ka qenë e lehtë, por është historike përnjëmend edhe goxha njëfarë grope. Mbi 250 milionë tenderë njëburimorë (vrime të lavdishme buxhetore) për dosta e miq, janë historike por aspak për të mirë dhe organet e drejtësisë herët a vonë do të kenë

shumë punë”, ka thënë Haradinaj. Sipas liderit të AAK-së, asnjë njohje për katër vjet qeverisje, asnjë anëtarësim. “Sipas ASK-së qeveritare gjatë qeverisjes së Kurtit, mbi 200 mijë qytetarë e kanë braktisur Kosovën, ani se për filozofët e qeverisë, Kosovën po e braktisin gjyshet! Gropa apo vrime të mëdha këto që ky kryeministër e kjo qeveri, nuk kanë as dije, as vullnet e as kohë t’i sanojnë. Ata tash janë orientuar nga zgjedhjet e radhës që janë mashtrimi i radhës”, ka thënë Haradinaj.

## AKB-ja kundërshton vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës që ndalon automjete transportuese me peshë mbi 7.5 tonë

Prishtinë, 15 korrik - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) e kundërshton vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës që ndalon automjete transportuese dhe komerciale me peshë mbi 7.5 tonë nga data 14 korrik deri më 31 korrik të 2024-s, nga ora 11:00 deri në orën 17:00. Sipas AKB-së, ky kufizim është jo i

analizuar mirë dhe do të ketë pasoja negative në ekonominë vendore dhe ndërkombëtare me rritjen e kostonë së transportit, rritjen e kostonë së logjistikës shkarkuese dhe ngarkese të mallrave si dhe rritjen e çmimeve për shërbime dhe produkte.

Agim Shahini, kryetar i AKB-së, ka theksuar se Ministria e

Infrastrukturës duhet të rritë kriteret e kualitetit e ndërtimit të rrugëve dhe asfaltit. “Kualiteti i përballon edhe temperaturës së lartë dhe asaj të ulët e jo ta ndalojë qarkullimin e automjeteve komerciale, sepse kjo do të krijojë humbje të madhe ekonomike për bizneset kosovare”, ka thënë Shahini.





# Media e njëanshme i bën një dhuratë të madhe Trumpit



E kemi parë të ndodhë shumë herë në Shtetet e Bashkuara. John dhe Robert Kennedy u vranë, Ronald Reagan u plagos rëndë. Tani ka qenë radha e Donald Trump, i cili është gjallë vetëm për disa milimetra, duke pasur parasysh se u qëllua në vesh dhe është e qartë se donin ta vrisnin. Rrethanat janë të ngjashme: si atëherë, edhe dje ishte një gjest nga një njeri i vetmuar, në këtë rast i vrarë menjëherë. Një i ri njëzet vjeçar që urrente Trumpin, gjë që megjithatë nuk sqaron gjithçka: A vepro i vetëm? A kishte bashkëpunëtorë? A mund të përjashtojmë që të jetë i nxitur? Pyetje delikate dhe pa përgjigje, por që ekspertit dhe vëzhguesi

skrupuloz nuk mund të mos i bëjë. Ashtu si rrethanat e tjera të përsëritura: sipas dëshmisë së marrë nga BBC, disa të pranishëm panë snajperin të ngjitej në çati, por alarmi u shpërfill. Dëshmia duhet marrë me kujdesin e duhur, megjithatë një fakt objektiv mbetet: mitingu u zhvillua në Butler, një qytet në Pensilvani me 13 mijë banorë. Fakti i thjeshtë që një burrë i armatosur me pushkë mundi t'i afrohej lirshëm vendit të tubimit është absurd dhe akoma më absurd që tarracat e zonës nuk ishin të mbuluara nga Shërbimi i Fshehtë, dhe se Matthew Crooks ishte në gjendje të ngjitej në një ndërtesë 150 metra larg skenës,

e të vendosej në pozicion gjuajje. Më e pakta që mund të thuhet është se siguria dështoi tërësisht. Shqetësuese.

Po aq zhgënjyese dhe emblematike ishte sjellja e shtypit amerikan, shpesh i kopjuar pa asnjë rezervë nga shtypi evropian. Çdo gazetar do të kishte vendosur titull në këtë mënyrë, aq më tepër që pamjet e drejtpërdrejta televizive ishin elokuate: "Sulm ndaj Trump, plagoset ish presidenti" ose "Të shtëna në tubim, u përpoqën të vrisnin Trump". E megjithatë fillimisht titujt ishin të vagët e madje deri të paqartë. "Të shtëna në mitingun e Trump" ishin më të guximshmit, ndërsa Washington Post vendoste

titullin: "Trump largohet pas zhurmave të forta në një tubim" dhe CNN bashkë me gazetat e tjera: "Agjentët e shërbimit sekret e largojnë urgjentisht Trumpin pas rrëzimit në një miting." Pa patos, pa emocion, një neutralitet rrëqethës. Ky atentat ndryshon incerinë e fushatës elektorale, dhe jo vetëm për imazhin ikonik të Trumpit, i cili me fytyrën e përgjakur, ngrihet dhe duke shpërfillur rrezikun, ngre grushtin lart dhe bërtet: "Luftoni, luftoni!" Tamam si një kryekomandant, siç i pëlqen ta quajë një pjesë e madhe e elektoratit. Tashmë është edhe viktimë dhe mund ta shfrytëzojë më shumë se kurrë rolin e presidentit

antisistem, si njeriu që e shqetëson kaq shumë establishmentin, sa që rrezikon edhe jetën. E ndihmon edhe përballja me demokratët. Edhe armiqësia e shtypit shkon në favor të tij. Tani bëhet vërtet e vështirë të ndalet rendja e kandidatit republikan, edhe pse nuk është e pamundur. Kjo është fushata më e çuditshme dhe e paparashikueshme e historisë së SHBA. Steka është shumë lartë. Kemi parë një president që bën vetëm gafa, ndërkohë që rivali është viktimë e një atentati. Dhe duhene dhe katër muaj deri në ditën e votimit. Çfarë do të ndodhë nga sot deri në 5 nëntor? / Inside Over – Bota.al

## Biden, vendimi merret brenda një jave

Më e shumta një javë, thjesht për të shmangur sikletin e ndryshimit të lidërshiptit në mes të samitit të NATO-s, kur liderët e Aleancës do të jenë në Uashington për të festuar shtatëdhjetë e pesë vjetorin e themelimit të saj dhe për të "ndërtuar urën" për futjen e Ukrainës. Por më pas do të duhet të merret një vendim për të ardhmen e rikandidimit të Joe Biden për Shtëpinë e Bardhë, cilido qoftë ai. Faqja e internetit Axios shkruante se demokratët shpresojnë për tërheqje deri të premtën, ndërsa gjatë takimit të deputetëve të thirrur dje nga kreu i tyre, Hakeem Jeffries u ngritën zëra të tjerë për të kërkuar ndryshim në garë. Dje Biden e nisi ditën në Kishën Mount Airy Church of God in Christ në Filadelfia, për një aktivitet të fushatës zgjedhore me komunitetin afrikano-amerikan.




Peshkopi Felton i ftoi besimtarët të përqafonin njëri-tjetrin dhe u lut kështu: «Armiku është përpjekur të na përçajë prej kohësh. Ai ka përdorur mosmarrëveshje sipërfaqësore, gjëra që nuk kanë asnjë rëndësi, vetëm për të na kthyer kundër njëri-tjetrit. Jemi bashkë sepse e duam presidentin tonë, lutemi për presidentin tonë, kërkoj që të

vazhdoni t'i jepni forcë." Më pas kreu i Shtëpisë së Bardhë fluturoi në Harrisburg, po në shtetin kyç të Pensilvanisë, për të marrë pjesë në një aktivitet me sindikatat. Iniciativa të nevojshme për të demonstruar se ai ka forcën për të vazhduar udhëheqjen e fushatës elektorale, me synimin për të qetësuar ata që besojnë se nuk ka më energji.

Zëvendësja, Kamala Harris shkoi në Festivalin e Kulturës në New Orleans, të titulluar "Chief to Chief", ku e përmendi Biden vetëm një herë për t'i kërkuar rizgjedhjen. Sikur të mos mjaftonin problemet ekzistuese, bashkëshorti i saj Doug Emhoff rezultoi pozitiv me Covid, por ajo që mund të bëhet së shpejti kandidate për Shtëpinë e Bardhë është negative. Në të njëjtën kohë, kreu i demokratëve në Kongres, Hakeem Jeffries, thirri një takim me kolegët për të matur pulsën dhe për të kuptuar se çfarë synojnë të bëjnë. Të paktën katër ligjvënës i kanë kërkuar presidentit të bëjë një hap prapa: kreu i Komitetit Gjyqësor Jerry Nadler, anëtar i Komitetit të Mbrojtjes Adam Smith, anëtar i Komitetit të Çështjeve të Veteranëve Mark Takano nga Kalifornia si dhe Joseph D.

Morelle nga Nju Jorku, udhëheqës i Komitetit Administrativ. Një zyrtar anonim i Shtëpisë së Bardhë i tha New York Times se ai dhe disa kolegë gjithashtu kanë filluar të dyshojnë. Sot senatori Warner do të takohet me kolegë skeptikë. Kështu, dallga e dyshimit së brendshmi fryhet, ndërkohë që financuesit e Hollivudit janë ankuar edhe te përfaqësuesi i tyre, Jeffrey Katzenberg, duke e akuzuar se ka gënjyer për gjendjen fizike të Biden, për të marrë kontributet e tyre. Sipas Axios, demokratët shpresojnë se presidenti do të shpallë tërheqjen deri të premtën e ardhshme. Sot liderët e NATO-s nisin të mbërrijnë për samitin në Uashington dhe të enjten pasdite kreu i Shtëpisë së Bardhë do të mbajë konferencën për shtyp. Më pas, gjithçka do të bëhet e mundur. / bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## FC Prishtina paraqet Samuelin dhe Raqin

**PRISHTINË, 15 KORRIK (ER)** - Skuadra e Prishtinës ka goditur në fatin kalimtar me dy transferime. Fjala është për sulmuesin Elijah Boimbo Mpaka Samuel dhe qendërmbrojtësin Ron Raqi. Samuel ka lindur në vitin 2002 dhe në skuadrën e Prishtinës vjen nga Franca, nga skuadra AS Saint-Ouen-L'Aumone. “Më pëlqen Prishtina. Përpara Prishtina! Po, patjetër, kam shumë vetëbesim dhe këtë dua t’ua dëshmoj edhe tifozëve tanë. Premtoj që do të asistoj e të shënoj sa më shumë që të bëj të mundur të dalim në Evropë”, ka thënë Samuel për

faqen zyrtare të Prishtinës. Trajneri tjetër është Ron Raqi, i cili ka kaluar nëpërmjet Ramiz Sadikut, klubin e Prishtinës në kategoritë e reja, Besën e Pejës dhe Trepçë '89, ndërsa te skuadra e Prishtinës angazhohet nga verdhezinjtë e Prishtinës. “Është nder i madh për mua të jem profesionist i klubit më të madh në trojet shqiptare. Do ta jap maksimumin, ndërsa mbetet nga kryetrajneri të përcaktohet për më të mirët. Shpresoj që së bashku me ‘Plisat’ të arrijmë më të mirën e mundshme për klubin”, ka deklaruar Raqi.



## Begolli emërohet trajner i Lirisë

**PRIZREN, 15 KORRIK** - Klubi me traditë të madhe në futbollin e Kosovës, Liria nga Prizreni, ka paraqitur sot trajnerin e ri, Granit Begolli. Ky i fundit ka punuar edhe në të kaluarën në klubin prizrenas. Derisa pritet në klubin e Lirisë me trajnerin e ri janë të mëdha. “FC Liria ka

kënaqësinë të njoftojë zyrtarizimin e Granit Begollit si trajnerin tonë të ri për sezonin e ardhshëm! Begolli po rikthehet te Liria pas dy sezonesh, duke sjell me vete përvojën, njohurinë dhe pasionin e tij për futbollin. Koha e tij e mëparshme me klubin u karakterizua nga

udhëheqja e jashtëzakonshme dhe kuptimi i thellë i lojës, cilësi që jemi të lumtur t'i mirëpresim përsëri. Në drejtimin e tij, presim një sezon të mbushur me ekselencë strategjike dhe lojë pasionante. Mirë se vjen përsëri, Granit!”, thuhet në njoftimin e Lirisë.

## Gjakova: Në Paris shkoj për ta bërë krenare Kosovën

**PRISHTINË, 15 KORRIK** - Në Lojërat Olimpike në “Paris 2024” Kosova do të përfaqësohet nga nëntë sportistë. Pesë nga sporti i xhudos, dy nga noti, një nga boksit dhe një nga sporti i atletikës. Pritjet më të mëdha për të fituar medalje janë nga xhudoja, aty ku do të luftojë për medalje edhe xhudisti Akil Gjakova. Ai ka thënë se shkon në Paris për ta bërë krenar Kosovën

duke arritur rezultat sa më të mirë. “Hera e dytë si sportist e përfaqësimit tim të Kosovës në Lojëra Olimpike. Pas vendit të shtatë në ‘Tokio 2020’, kësaj radhe me një fokus dhe një qëllim më të qartë, ta bëjmë Kosovën krenare”, ka thënë Gjakova. Lojërat Olimpike në Paris do të zhvillohen nga data 26 korriku deri më 11 gusht.



## Rrahmani: Napoli rikthehet aty ku e ka vendin

**NAPOLI, 15 KORRIK** - Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, u shpreh se është gati për sezonin e ri me Napolin. “Ne e dimë se të gjithë duhet të punojmë shumë për t’u rikthyer atje ku duhet të kthehemi. Në fillim nuk po punojmë aq shumë në lojë. Bëjmë më shumë punë fizike. Rafa Marin? Ai është zgjedhur nga drejtori dhe trajneri ynë, ndaj duhet të jetë i fortë. Tashmë mund t’i shihni cilësitë e tij. Ai është sigurisht një lojtar i fortë. Conte? Fakti që ka qenë trajner i shumë skuadrave të mëdha, ku është e vështirë të stërvitesh dhe të arrish, flet vetë. Mbrojtja me tre lojtarë? Secili prej nesh duhet t’i ndjekë udhëzimet e trajnerit. Normalisht duhet pak kohë për t’i automatizuar lëvizjet dhe zgjedhjet, e vetmja gjë që mund të bëjmë tani është të punojmë, të përpiqemi të kuptojmë se çfarë dëshiron trajneri dhe ta



vendosim atë në fushë”, ka thënë Rrahmani. “Di Lorenzo? Të gjithë e prisnim atë sqarim sepse ai është kapiteni ynë. Jemi të lumtur që ai mbetet këtu me ne. Më i forti kundër të cilit kam luajtur? E kemi një në skuadër, është Osimhen, por edhe Rashford i Manchester

Unitedit”, ka shtuar ai. “Pozicioni im i preferuar? Te Verona kam luajtur në krahun e djathtë, por ndonjëherë edhe si qendërmbrojtës. Nuk ka asnjë problem për mua. Të shohim se ku më do trajneri”, ka deklaruar Rrahmani.

## Shaqiri pensionohet nga Kombëtarja e Zvicrës

**CYRIH, 15 KORRIK** - Xherdan Shaqiri në rrjetet sociale ka njoftuar se është pensionuar nga Kombëtarja e Zvicrës. Futbollisti kosovar

konsiderohet si një prej lojtarëve më të mëdhenj të Kombëtares helveteke, ndërsa ka shënuar gola të shumtë dhe mjaft të rëndësishëm për

Zvicrën. “Shtatë turne, shumë gola, 14 vjet në Kombëtaren e Zvicrës dhe momente të paharrueshme. Është koha t’i them lamtumirë Kombëtares.

Kujtime të mëdha do të mbesin dhe ju them të gjithëve: Faleminderit!”, ka shkruar Shaqiri në “Instagram”.





## Kane: Një tjetër mundësi e lëshuar, humbje që dhemb

**BERLIN, 15 KORRIK** - Kapiteni i Anglisë, Harry Kane, e ka komentuar humbjen e “Tre Luanëve” në finale të “Euro 2024” nga Spanja, ndërsa dukej i mërztur dhe i dërmuar pasi e humbi finalen e dytë radhazi të Evropianit me anglezët. “Është e vështirë ta përshkruash me fjalë

se si ndihemi në këtë moment. Ishte një ndeshje e vështirë, ishim në gjendje të ktheheshim në lojë, por hasën në vështirësi të vazhdonim të ndërtonim. Të pësosh gol në fund është me të vërtetë e vështirë që ta pranosh”, ka thënë Kane. “Kemi bërë përmbyse gjatë tërë

kampionatit, por në këtë ndeshje nuk e bëmë hapim pasues për të fituar. Në pjesën e parë kemi hasur në vështirësi. Nuk mund të arrinim ta merrnim posedimin. Pjesa e dytë ishte më e mirë dhe kemi shënuar. U befasuam nga një harkim dhe ky ishte fundi. Është

një mundësi e humbur. Nuk është e lehtë të arrish në kesi finale. Duhet ta shfrytëzosh rastin kur të të vijë dhe ne nuk e bëmë këtë sërish. Na vjen ekstremisht keq dhe kjo do të na lëndojë shumë gjatë. Të gjithë dëshironim të fitonim”, ka shtuar Kane.



## Mulleri tërhiqet nga kombëtarja: Jam shumë krenar që kam luajtur për vendin tim

**MUNCHEN, 15 KORRIK** - Thomas Muller ka deklaruar tërheqjen nga kombëtarja gjermane. Lajmin e ka konfirmuar vetë 34-vjeçari përmes një videomesazhi të publikuar në rrjetet sociale. Mulleri deklaroi se është shumë krenar që ka luajtur për Gjermaninë, teksa i jep lamtumirë kombëtares, pas 131 ndeshjeve të luajtura, ku shënoi 45 gola dhe fitoi Kupën e Botës në vitin 2014. “Gjithçka filloi këtu në Pahl në këtë fushë sportive. Entuziazmi im i madh për futbollin. Kur isha në gjendje të luaja ndeshjen time të parë ndërkombëtare për kombëtaren gjermane më shumë se 14 vjet më parë, nuk do ta kisha ëndërruar kurrë të gjitha. Fitore të mëdha dhe disfata të hidhura. Ndonjëherë i shkatërruar, vetëm për t’u rikthyer përsëri. Duke konkurruar kundër lojtarëve më të mirë në botë, përkrah shokëve fantastikë të skuadrës me të cilët kam përjetuar momente të paharrueshme. Pas



131 ndeshjeve ndërkombëtare dhe 45 golave, i them lamtumirë Gjermanisë sot”, ka thënë Muller. “Unë kam qenë në gjendje të marr pjesë në katër Kupa Bote dhe katër Kampionate Evropiane, të ngre trofeun e Kupës së Botës dhe ta ndiej dashurinë tuaj në fushë. Më ka bërë gjithmonë shumë krenar që luaj për vendin tim. Kemi festuar së bashku dhe ndonjëherë derdhëm lot bashkë. Dua t’u them

faleminderit të gjithë tifozëve dhe anëtarëve të ekipit kombëtar. Faleminderit për mbështetjen tuaj gjatë vitit të kaluar! Mërmë me vete entuziazmin dhe gëzimin e Euros së këtij viti dhe mbani gishtat e kryqëzuar për ekipin në rugën drejt Kupës së Botës 2026. Edhe unë do ta bëj këtë. Tani si tifoz në tribunë dhe jo më si lojtar në fushë e gjelbër. Shihemi!”, ka shtuar Mulleri.

## Ish-piloti i Formulës 1, Ralf Schumacher, zyrtarizon lidhjen me një mashkull

**HURTH, 15 KORRIK** - Ralf Schumacher, vëllai i shtatë herë kampionit të botës në Formula 1, Michael Schumacher, zbulon marrëdhënien e tij homoseksuale. Me një postim në rrjetet sociale, ai zbulon të vërtetën, ku është duke përqafuar partnerin e tij Etienne në perëndim të diellit. Përmes këtij postimi, Ralf Schumacher dukej se donte t’u hapej ndjekësve të tij për seksualitetin e tij. “Gjëja më e mirë në jetë është të kesh partnerin e duhur në krah për të ndarë gjithçka me të”, shpjegoi ish-piloti gjerman në mbishkrimin që shoqëron imazhin. Dalja e Ralf Schumacherit gjeti menjëherë mijëra pëlqime dhe qindra komente në mbështetje të vendimit të tij për ta bërë publike marrëdhënien e tij homoseksuale në një botë, siç është ajo e



motorsportit, ku është e rrallë të flitet për shoferë që kanë të tilla marrëdhënie. Në Formula 1, Ralf Schumacher garoi për Jordanin, Williams dhe Toyota, për gjithsej 182 gara të mëdha, me 6 fitore, 6 pole

position dhe gjithsej 27 podiume. Ralf ishte i martuar me Cora Brinkmann nga viti 2001 deri në 2015 dhe është babai i David Schumacherit, fitues i një gare F3 më 2021.

### SHKURT

#### Argjentina fiton Kupën e Amerikës

Argjentina është fituesja e Kupës së Amerikës për sezonin 2023-2024. “Albiçelestet” morën një fitore të vuajtur me rezultat minimal 1-0 ndaj Kolumbisë. Ndeshja në 90 minuta përfundoi në barazim pa gola, teksa vetëm në kohën shtesë, në minutën 112, argjentinasiit kaluan në avantazh me gol të Lautaro Martinezit.

Kampionët e botës në fuqi fituan Kupën e Amerikës për herë të dytë radhazi, teksa të njëjtin sukses e arritën edhe në edicionin e mëparshëm. Argjentina mbeti pa Lionel Messin, pasi tetë herë fituesi i Topit të Artë u lëndua dhe u largua nga loja në minutën e 66.

#### Trajneri i Spanjës: Kemi një gjeneratë të artë futbollistësh

Spanja triumfoi në finalen ndaj Anglisë (2-1). Trajneri Luis de la Fuente nuk mundi ta fshehë gëzimin për suksesin e arritur. Ai ka thënë se spanjollët kanë një të tashme dhe të ardhme të ndritur. “Le t’i gëzojemi momentit, kemi një të tashme dhe një të ardhme të mrekullueshme. Kemi një gjeneratë të artë futbollistësh. Yamal dhe Williams janë dy djem fantastikë, të jashtëzakonshëm, të cilët mund të rriten më shumë. Jemi me fat që i kemi në skuadër”, ka thënë Luis de la Fuente.

#### Williams: E merituar këtë sukses

Spanja triumfoi 2-1 në finalen përballë Anglisë me rezultat 2-1. Një festë e jashtëzakonshme për “La Roja-n” që me plot meritë, pasi fituan 7 ndeshjet e zhvilluara dhe arritën ta fitonin titullin e katërt në histori. Atmosfera ishte shumë entuziaste në përfundim të sfidës me Nico Williams që ishte një nga protagonistët e mëdhenj të këtij evropiani. “Jam shumë euforik, të gjithë ne e meritojmë. Ndeshja ishte e vështirë, luftuam ndaj një skuadre të madhe. Roli im? Unë ndihem shumë mirë në çdo rol, më pëlqen madje të ndryshoj shpesh pozicionin”, ka shtuar Williams.

#### Bellingham: Zhgënjyese që nuk ia dolëm të bëjmë histori

Anglia pësoi humbje në finale të Kampionatit Evropian “Euro 2024” nga Spanja (2-1). Pas ndeshjes i zhgënjyer ishte Jude Bellingham, i cili ka thënë se janë munduar të bëjnë histori dhe t’i bëjnë njerëzit në Angli krenarë, por që nuk ia dolën. “Ne nuk deshëm asgjë përveçse të bëjmë më shumë histori dhe t’i bëjmë njerëzit e Anglisë krenarë, por nuk ia dolëm. Do ta analizojmë këtë. Është një grup i ri”, ka thënë Bellingham. “Është zhgënjyese sepse ne duhet të bëjmë më shumë, por janë disa gjëra që mund të nxjerrim nga kjo. Si skuadër, ne do të marrim gjërat pozitive dhe negative dhe duhet të gjejmë një mënyrë për të fituar”, ka shtuar Bellinghami.

## Southgate: Nuk është momenti të flas për të ardhmen

Duket se mallkimi për trajnerin e Anglisë, Gareth Southgate (53 vjeç), në kampionatet evropiane është i pashmangshëm. Për të dytin edicion me radhë ai ndalet në finale, fillimisht nga Italia (tri

vite më parë) dhe tash nga Spanja. I kryqëzuar shumë kohët e fundit nga media britanike, trajneri ende nuk ka vendosur se çfarë do të bëjë tani që përfundoi “Euro 2024”. Kontrata e tij skadoi

pas përfundimit të turneut, ndërkohë që Federata dëshiron t’ia shtyjë deri në fund të botërorit të ardhshëm. “E ardhmja? Nuk mendoj se është koha e duhur për të marrë një vendim si ky

në këtë moment, kur jemi të gjithë gjaknxehtë për këtë humbje. Më duhet të flas me njerëzit e duhur. Nuk është momenti. Kam nevojë të mendojem”, ka thënë Southgate, i cili numëron 102

ndeshje në krye të kombëtares së “3 Luanëve”, por shpesh është kritikuar edhe nga tifozët. Ai ka arritur 61 fitore, 24 barazime e 17 humbje në detyrën e trajnerit të Anglisë që nga viti 2016.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kulla Mall” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812125723 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kulla Mall” D.O.O. od Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812125723 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Kulla Mall” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812125723 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ben Islami shpall të humbur Çertifikaten e Regjistrimit për TVSH me numer serik: 3012613 si dhe numeri biznesi nrb: 70104645

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi







# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
®  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

